
RAPORTI 6 MUJOR

GUSHT 2022 - JANAR 2023



**RAPORTI 6 MUJOR PËR VEPRAT PENALE TË
KORRUPSIONIT, KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE
DROGËS**



Përgatiti : Z.Endri Plasari, Ekspert i Jashtëm

Kontribuan në hartimin e raportit :

Znj. Esmeralda Keta, Gazetare, Eksperte e Jashtme

Znj. Bleona Metushi, Gazetare, Eksperte e Jashtme

Rishikoi:

Znj. Anila Hoxhaj, Drejtor Egzekutiv Qendra “Fol”

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: © Qendra “FOL”

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Qendra “FOL” në adresën e mëposhtme:

Adresa: Rruga “Pjetër Budi” , godina numër 69, Tiranë

E-mail: gendrafol@gmail.com

Telefon: +355682082888

Ky raport është pjesë e projektit “FOL PËR DREJTËSINË”, që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Qendrës “FOL” dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.



TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	1
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	1
3. METODOLOGJIA	4
4. SPAK	5
4.1 Kallëzimet penale në SPAK	5
4.1.1 Korrupsioni	7
4.1.1.1 Vështrim mbi çështjet e korrupsionit për periudhën Gusht 2022-Janar 2023	8
4.1.1.2 Raport Gjinator për të proceduarit në fushën e korrupsionit	12
4.1.2 Krimi i organizuar	14
5. PUNA E QENDRËS FOL NË PËRDITËSIMIN E RASTEVE TË DROGËS, KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR	16
5.1 Shpallja e moskompetencës	Error! Bookmark not defined.
5.2 Kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve penale	24
DISA PROBLEMATIKA LIDHUR ME MONITORIMIN E ÇËSHTJEVE DHE AKSESIN NË INFORMACION	26

1. HYRJJE

Qendra “FOL”, në kuadër të projektit “Fol për Drejtësinë”, me mbështetjen financiare të Ambasadës së SHBA-ve në Tiranë, gjatë muajve Gusht 2022 – Janar 2023 ka monitoruar në mënyrë pro aktive veprimtarinë e organeve ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale në fushën e drogave. Ekspertët e Qendrës “FOL” kanë përditësuar bazën e të dhënave “Fol” me raste të reja. Ekspertët e Qendrës “Fol” gjurmojnë rastet duke nisur që nga ndjekja penale, kryerja e hetimeve dhe ngritja e akuzës për një vepër penale në gjykatë. Raporti përmbledh analizë dhe statistika mbi rezultate, mënyrës së fillimit të ndjekjes penale dhe kallëzimet e regjistruara, rastet kur kompetenca lëndore ka kaluar për kompetencë në prokurori të tjera, të dhënat për përfundimin e procedimeve penale me numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim, shpërndarjen e veprave penale sipas neneve të parashikuara në Kodin Penal, masat e sigurimit personal kërkuar nga prokuroria në raport me masat e dhëna nga Gjykata etj.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë monitorimit 6 mujor të realizuar, ekspertët e Qendrës “FOL” kanë paraqitur disa gjetje të përfshira në këtë seksion të përmbledhjes ekzekutive:

1. Në këtë periudhë raportimi ekspertët e Qendrës “Fol” kanë ndjekur duke regjistruar në databazën online “Fol” (FOL) 79 raste të reja që i përkojnë periudhës gusht 2022 – janar 2023, në kuadër të monitorimit të punës së Prokurorisë së Posacme Antikorrupsion. Rastet janë të bëra publike nga palët dhe njoftimet zyrtare të vet SPAK. Gjithashtu ekspertët kanë përditësuar të dhënat për 197 raste që i përkojnë periudhës Korrik 2020 – Tetor 2021 , në kuadër të monitorimit të SPAK dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Nga rastet e monitoruara në periudhën gusht 2022 – janar 2023, 40 janë në kategorinë e korrupsionit, 31 në kategorinë e drogës dhe 8 në kategorinë e krimit të organizuar.
3. Në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë paraqitur 16 kallëzime penale, ku kallëzimet për veprën penale ka ardhur nga qytetarët në 7 raste, nga avokatë në 4 raste, nga gazetarë në 2 raste, nga një zyrë ligjore në 1 rast, nga Zyra e Përmbaruesve Gjyqësor në 1 rast dhe nga një parti politike në 1 rast tjetër.
4. Janë 2 çështje me nga 2 shtetas secila për të cilat Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillim të hetimeve.
5. Për periudhën gusht 2022 – janar 2023 është evidentuar vetëm 1 rast kur Prokuroria e Posaçme, pas vlerësimit të materialit kallëzues e dërgoi për kompetencë në Prokurorinë e Tiranës. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi për mosfillim të procedimit penal.
6. Janë regjistruar në total 7 procedime penale me 58 të pandehur, pjesën më të madhe të cilave e përbënin procedime penale në fushën e korrupsionit (4) ose 57% e procedimeve.
7. Është regjistruar 2 procedime penal në fushën e drogës me 31 persona që akuzohen për përfshirje në grup të strukturuar kriminal dhe trafik të lëndëve narkotike.
8. Nga 79 raste të reja 40 janë nën kategorinë e korrupsionit. Praktikisht janë 51 % e të gjitha rasteve të trajtuara në këtë periudhë 6 mujore.
9. Numri i të proceduarve të gjinisë femërore për veprat penale në fushën e korrupsionit është 3.
10. Për periudhën rezultojnë 8 të pandehur për 2 çështje në fushën e krimit të organizuar dhe në të gjitha rastet është kërkuar nga Prokuroria e Posaçme vendosja nën masë sigurimi “arrest në burg”.
11. Akuzat kryesore penale, të cilat përbëjnë numrin më të lartë në procedimet penale në fushën e krimit të organizuar lidhen me: Grupin e strukturuar



kriminal; Kryerjen e veprave nga grupi i strukturuar kriminal; Prodhimin dhe shitjen e narkotikëve si edhe Trafikimin e lëndëve narkotike.

12. Ekspertët e Qendrës “FOL” kanë përditësuar databazën “Fol” me të dhëna të reja për rastet e korrupsionit të monitoruara gjatë periudhës Korrik 2020 – Tetor 2021. Janë 3 çështje penale ndër të tjerat me 12 shtetas të proceduar në fushën e korrupsionit për të cilat ekspertët kanë reflektuar ndryshimin në statusin e gjykimit dhe evidentuar veçantë në raport.
13. Gjatë fazës së monitorimit për hartimin e këtij raporti vlerësimi 6 mujor grupi i punës ka hasur në disa kufizime lidhur me informacionin e plotë dhe të publikuar online nga SPAK, Gjykata e Posaçme e Shkallës së parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.


3. METODOLOGJIA

Raporti 6 mujor gusht 2022 -janar 2023 është realizuar duke u bazuar në të dhënat e platformës “Databaza Fol”. Gjatë kërkimit sasior dhe cilësor është realizuar një hetim sistematik me fokus në vlerat numerike. Paraqitja e të dhënave shfaqet në formë tabelore, si grafik dhe si imazh, shoqëruar nga analiza përshkruese. Statistikat përshkruese tregojnë dhe përmbledhin tiparet themelore të një grupi të dhënash të gjetura në “Databazën “Fol”, të paraqitur në një përmbledhje që përshkruan mostrën e të dhënave dhe matjet e saj. Për realizimin e raportit është proceduar me mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave të realizuar nga gazetarët në bazën e të dhënave të quajtur “Databaza “FOL”, saktësimin, normalizimin e të dhënave dhe kontrollin e cilësisë së të dhënave, analizimin e të dhënave dhe vizualizimin e analizës nëpërmjet gjenerimit të raporteve sipas kërkesave të projektit. Në raport paraqiten dhe disa të dhëna nga projekti “Fol për Drejtësinë” 2020-2021, duke qenë se ekspertët e Qendrës “Fol” vazhdojnë të përditësojnë statusin e hetimit apo statusin gjyqësor të rasteve të trajtuara në projektin e mëparshëm. Gjetjet në raport përbëjnë një vlerësim bazë të konsoliduar me qëllim vlerësimin e efektivitetit në lidhje me shqyrtimin gjyqësor të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar të regjistruara gjatë intervalit kohor gusht 2022-janar 2023. Puna e ekspertëve shërben për të krijuar një sistem të konsoliduar të të dhënave për të rritur transparencën në sistemin e drejtësisë dhe matjen e cilësisë duke gjurmuar problemin që nga nisja e procedimit penal dhe deri në fund kur jepet një vendim gjykate. Në këtë kontekst, mangësitë e hasura dhe identifikuara më lart gjatë mbledhjes së të dhënave kanë gjithashtu si qëllim të shërbejnë si sugjerime dhe rekomandime për institucionet respektive me qëllim adresimin dhe përmirësimin e tyre në të ardhmen.

4. SPAK

4.1 Kallëzimet penale në SPAK

Ekspertët e Qendrës “FOL” kanë monitoruar kallëzimet penale të bëra publike nga palët, që janë paraqitur pranë SPAK. Në periudhën e raportimit gusht 2022- janar



Grafiku 1 Të kallëzuarit në SPAK Gusht 2022 – Janar 2023

**Ish Presidenti i Republikës
Ilir Meta është kallëzuar në
SPAK në 4 raste**


2023, ekspertët e Qendrës “FOL” kanë konstatuar se në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar janë paraqitur **16 kallëzime** penale ku kallëzimet për veprën penale kanë ardhur nga qytetarët në 7 raste , nga avokatë në 4 raste, nga gazetarë në 2 raste, nga një

zyrë ligjore në 1 rast, nga Zyra e Përmbardësve Gjyqësor në 1 rast dhe nga një parti politike në 1 rast tjetër. Këto janë kallëzime në ngarkim të 21 shtetasve, ku përfshihen ish Presidenti i Republikës, gjyqtarë, Ministër në detyrë, Kryetar Bashkie, zyrtarë të administratës publike, biznesmenë, prokurorë të SPAK.

Vetëm në **1 rast** Prokuroria e Posaçme, pas vlerësimit të materialit kallëzues, e dërgoi për kompetencë në Prokurorinë e Tiranës pasi veprat penale dhe subjektet e kallëzuara nuk ishin në kompetencën e SPAK. Rezulton se për **2 çështje** Prokuroria e Posaçme ka vendosur mosfillim të hetimeve. Në një nga këto dy çështje, konkretisht për

kallëzimin e bërë nga gazetari Adriatik Doçi ndaj dy prokurorëve të posaçëm për dyshimet se nuk kishin kryer veprimet hetimore të nevojshme për një dosje, u vendos për mosfillim me argumentin se nuk ka konsumim të veprës penale të “shpërdorimit të detyrës”. Në vendimin e mosfillimit, gjithashtu argumentohet se çështja ndaj të cilës është ngritur kallëzimi është ende në hetim nga dy prokurorët të cilët nuk kanë dalë në një përfundim. Vendimi nuk u ankimua. Në kallëzimin tjetër për të cilën është vendosur mosfillim i hetimeve, avokati që kishte paraqitur padinë penale kundërshtoi vendimin e mosfillimit dhe e ankimoi vendimin në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me vendimin Nr. 455, datë 30.11.2022 vendosi shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 07.10.2022, që lidhet me kallëzimin Nr. 142 të vitit 2022, në bazë të ankimit të kallëzuesit të bërë më datë 19.10.2022. Kundër vendimit të Gjykatës të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për shfuqizimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal ka bërë ankim Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë 20.01.2023.

Operacionet e SPAK – Krahas kallëzimeve publike në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ekspertët e Qendrës “FOL” kanë monitoruar edhe rastet hetimore të cilat janë finalizuar nga Prokuroria e Posaçme me masa sigurimi për periudhën gusht 2022 -janar 2023. Janë **58 raste** të monitoruara të SPAK për të cilat ekspertët kanë hedhur në bazën e të dhënave, statusin e hetimit dhe gjendjen gjyqësore. Sipas kategorisë së veprave penale të hetuara ka rezultuar se **31 raste janë në fushën e**



Grafiku 2 Shpërndarja e rasteve sipas kategorive
Gusht 2022 - Janar 2023

drogës, 19 në fushën e korrupsionit dhe 8 në fushën e krimit të organizuar. Janë regjistruar në total 7 procedime penale me 58 të pandehur, pjesën më të madhe të cilave e përbënin procedime penale në fushën e korrupsionit (4) ose 57% e procedimeve. Vetëm 1 është për çështjet

penale në fushën e krimit të organizuar. 2 procedime penal në fushën e drogës me 31 persona që akuzohen për përfshirje në grup të strukturuar kriminal dhe trafik të lëndëve narkotike.

4.1.1 KORRUPSIONI




Figurë 1 Harta e vendeve në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore ku reflektohet Indeksi i Perceptimeve mbi Korrupsionin për vitin 2022 realizuar nga Transparency International

Shqipëria vazhdon të rezultojë një vend me problematika të theksuara në drejtim të luftës ndaj korrupsionit. Në Indeks Global të Transparency International për Korrupsionin në Botë për vitin 2022, Shqipëria zë vendin e 101 ndër 180 vende.¹

¹ Renditja e Shqipërisë sipas Indeksit Global mbi korrupsionin Transparency International <https://www.transparency.org/en/countries/albania>

Transparency International publikon gjithashtu Indeksin për Perceptimin e Korrupsionit, i cili është një nga indikatorët botëror për korrupsionin e sektorit publik. Shqipëria ka rezultuar me një vlerësim 36/100 ku 0 është vlerësimi për shumë të korruptuar dhe 100 për shumë i pastër. Në hartën e Transparency International për vitin 2022 Shqipëria rezulton të jetë dhe më poshtë se Mali i Zi, Kosova apo Maqedonia e Veriut.




Grafiku 3 Paraqitja e indeksit mbi perceptimin e korrupsionit për vendet e Ballkanit Perëndimor 2012 - 2022

Në një tjetër indeks, atë të World Justice Project, që mat Indeksin për Sundimin e Ligjit, Shqipëria renditet e 87 ndër 140 vende. Në vitin 2022 ka zbritur dhe 4 vende më shumë, madje rezulton të jetë shumë larg Bosnjë dhe Hercegovinës që është në vendin e 70 apo Kosovës që është renditur në vendin e 57.

4.1.1.1 Vështrim mbi çështjet e korrupsionit për periudhën Gusht 2022-Janar 2023

Në raportin 6 mujor të projektit “Fol për Drejtësinë” në periudhën gusht 2022 – janar 2023 ekspertët e Qendrës “FOL” kanë trajtuar **79** raste të reja prej të cilave **40** janë nën kategorinë e korrupsionit. Praktikisht janë **51 %** e të gjitha rasteve të trajtuara në këtë periudhë 6 mujore. Janë proceduar penalisht **19 persona** për konsumim të veprave penale të parashikuar nga nenet 143/3, 25, 144/a, 25, 245, 25, 248, 259, 287, geramat

(a) dhe (b), 333/a të K. Penal. Në 14 raste është kërkuar masa personale e sigurisë "arrest në burg", kurse në 4 raste të tjera masa "arrest në shtëpi". Numri i të proceduarve në fushën e korrupsionit sipas muajve:



Grafiku 4 Masat e Sigurimit për të proceduarit e korrupsionit sipas periudhave për 6 mujorin Gusht 2022 – Janar 2023

Ndër rastet e monitoruara nga ekspertët është evidentuar në 8 raste ekzistenca e konkurrimit të veprës penale. Për sa i përket veprave penale jo konkurruese rezulton se vepra penale e korrupsionit aktiv të funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendor, Neni 245 i K. Penal, përbën akuzën kryesore ndër rastet e monitoruara (**8 raste**). Nga hulumtimi i ekspertëve të Qendrës "Fol", në 4 raste

akuzat për korrupsion kundrejt funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë janë nën hetim nga Prokuroria e Posaçme kurse në 4 raste të tjera Prokuroria e Posaçme ka kërkuar që të pandehurit të vihen nën masat e sigurimit personal - "arrest në burg" për 3 të pandehur dhe "arrest në shtëpi" në një rast tjetër. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka miratuar caktimin e masave. Policia nuk ka mundur të gjejë të pandehurit ndaj masa e sigurimit ndaj tyre nuk është ekzekutuar. Të 4 të pandehurit janë shpallur në kërkim.

Prokuroria ka depozituar kërkesën për gjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë në **3 raste**.


Në ndryshim nga periudhat më përpara janë shfaqur raste të konsumimit të veprave penale parashikuar nga **nenet 143/b dhe 333/a** të K. Penal. **Janë 2 çështje penale** të monitoruara nga ekspertët, ku të akuzuarit kanë konsumuar këto dy vepra penale. Në



njërën prej çështjeve SPAK dhe prokuroria italiane për aktivitetin mashtrues të Call Center-ave në Shqipëri, kryen hetimet dhe kërkuan vendosjen e masave të sigurimit personale për 3 shtetas. Në çështjen tjetër Eurojust, SPAK dhe policia shqiptare pas hetimit të përbashkët mes 10 vendeve arrestuan 4 persona: dy për të cilët Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka dhënë masat e sigurisë **“arrest në burg” për 1 shtetas dhe “arrest në shtëpi” për 1 shtetas** tjetër, si të proceduar për veprat penale mashtrim kompjuterik dhe grup i strukturuar kriminal. Në të dyja çështjet që lidhen me këto vepra penale Prokuroria e Posaçme është vënë në lëvizje nga hetimet të nisura nga prokuroritë e huaja.

Në grupin e rasteve të shqyrtuara nga ekspertët e Qendrës “FOL” përfshihen ato të shtetasve të proceduar penalisht për veprën penale të krijimit të skemave mashtruese në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar, kryer në bashkëpunim. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nga hetimet e kryera ka arritur në përfundimin se janë 6 shtetas, që kanë organizuar dhe vënë në funksionim skema mashtruese në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar, me qëllim fitimin material për llogari të një shoqërie koncesionare që ka konsistuar në përfitimin e kreditimit të tatimit mbi vlerën e shtuar. Nga hetimi ka rezultuar se nga kreditimi i TVSH-së, bërë nëpërmjet faturimeve fiktive, i është shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit, në vlerën totale 59,915,020 (pesëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëzet) lekë. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në kuadër të hetimeve të këtij procedimi penal, ka kërkuar vendosjen nën masa sigurimi personale **“arrest në burg” për 11 të pandehur** dhe masë sigurie **“arrest në shtëpi” për 1 të pandehur** tjetër. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër


Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka miratuar caktimin e masave të sigurisë. Masa e sigurimit “arrest në shtëpi” e kërkuar nga prokurori për 4 shtetas, 2 prej të cilëve të gjinisë femërore, u miratua nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në rastet e shqyrtuara ka rezultuar se masat e sigurimit të vendosura nga Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk



Grafiku 5 Masat e sigurimit


kanë ndryshuar në raport me kërkesat e Prokurorisë, pra ka rezultuar në një përputhshmëri 100%. Nga 13 shtetasit për të cilët është paraqitur kërkesa për gjykim nga Prokuroria vetëm 2 janë të gjinisë femërore, ose 16%.

4.1.1.2 Raport Gjiner për të proceduarit në fushën e korrupsionit



Grafiku 6 Raport gjiner për të proceduarit në fushën e korrupsionit Gusht 2022 – Janar 2023

Numri i të proceduarve të gjinisë femërore për veprat penale në fushën e korrupsionit është **3**. Në **2 raste të pandehurit kanë** konsumuar veprat penale të mashtrimit kompjuterik dhe grupit të strukturuar kriminal. Këto **3** raste lidhen me **2** çështje penale ku në një të një prej tyre objekti i veprës është mashtrimi, i realizuar nga call center-a kurse




në çështjen tjetër është korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë ose të zgjedhurve vendorë.

Numri i të proceduarve meshkuj për çështje që lidhen me korrupsionin është **16**. Në raport me veprat penale që kanë konsumuar vihet re se në **4** raste të pandehurit kanë konsumuar veprën penale të “krijimit të skemave mashtruese në lidhje me tatimin e vlerës së shtuar”, kryer në bashkëpunim. Të pandehurit janë pjesë e çështjes penale nr.187 të vitit 2020, që i përket hetimeve për dosjen e konçensionit të inceneratorit të Fierit, për të cilën Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka kryer hetimet dhe ka evidentuar fakte penale për të cilat është kërkuar masa e sigurisë personale për **11 shtetas** për veprat penale “*Mashtrimi*”, *me pasoja të rënda, në bashkëpunim*, “*Krijimi i skemave mashtruese në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar*”, *në bashkëpunim*, “*Shpërdorimi i detyrës*”, “*Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*”, “*Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike*”, “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë*”, “*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*”, parashikuara nga nenet 143/3, 25, 144/a, 25, 245, 25, 248, 259, 260 dhe neni 287, germat (a) dhe (b) të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese “*në bashkëpunim*” sipas nenit 287, paragrafi (2) i Kodit Penal. Objekti i hetimit të këtij procedimi penal janë veprimet e kryera për procedurën e ndjekur në lidhjen e kontratës së koncesionit për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve në Qarkun e Fierit dhe prodhimin e energjisë. Në po të njëjtën çështje janë të përfshirë dhe **3 shtetas** të tjerë të akuzuar për veprën penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale apo i veprimtarisë kriminale*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287 paragrafi 1, shkronjat “a” dhe “b” të Kodit Penal, e kryer në rrethanën cilësuese “*në bashkëpunim*”, sipas nenit 287 paragrafi 2 i Kodit Penal.²

² Njoftime SPAK <https://spak.al/2022/12/20/njoftim-per-shtyp-9/>

Ky raport është pjesë e projektit “FOL PËR DREJTËSINË”, që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Qendrës “FOL” dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

4.1.2 KRIMI I ORGANIZUAR



Grafiku 8 Masa e sigurisë kërkuar nga SPAK dhe masa e dhënë nga GJKKO

Ekspertët e Qendrës “FOL” në periudhën e shqyrtimit gusht 2022- janar 2023 kanë monitoruar veprimtarinë e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në drejtim të hetimit, procedimit penal për veprat penale të kryera nga të pandehur në fushën e krimit të organizuar. Për periudhën rezultojnë **8 të pandehur në 1 çështje** në fushën e krimit të organizuar dhe në të gjitha rastet është

kërkuar nga Prokuroria e Posaçme vendosja nën masë sigurimi “arrest në burg”. Konstatohet se referimi i shtetasve nën masë sigurimi “arrest në burg” është statusi procedural më i përdorur, konkretisht në 100% të rasteve.

Çështja që është monitoruar nga ekspertët e Qendrës “Fol” ka të bëjë me procedimin penal Nr.184 të vitit 2019, një çështje e transferuar në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbi bazën e akteve të dërguara për kompetencë nga Prokuroria për Krime të Rënda për veprat penale “*Vrasja e funksionarëve publikë*”, mbetur në tentativë, “*Vrasja në rrethana të tjera cilësuese*”, mbetur në tentativë, “*Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit*”, “*Vjedhja*” e kryer më shumë se një herë” dhe “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga nenet 79/a-22; 79/dh-22; 278/1, 2; 134/2 dhe 333/a të Kodit Penal. Pas veprimeve hetimore, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” si dhe kontrollin e 10 ambienteve në qytete të ndryshme të Shqipërisë (Tiranë, Durrës, Krujë), kërkesë e miratuar nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e



Organizuar. Janë ekzekutuar **5 masa sigurimi personal** për 5 persona në hetim dhe janë shpallur në kërkim 4 shtetas të tjerë.³

Bazuar në të dhënat e marra nga ekspertët e Qendrës “FOL” mbi dosjen penale në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në fushën e krimit të organizuar për periudhën gusht 2022- janar 2023 ende nuk ka përfunduar hetimi për **çështjen**.


Akuzat kryesore penale, të cilat përbëjnë numrin më të lartë në procedimet penale në fushën e krimit të organizuar lidhen me: Grupin e strukturuar kriminal; Kryerjen e veprave nga grupi i strukturuar kriminal; Prodhimin dhe shitjen e narkotikëve si edhe Trafikimin e lëndëve narkotike.

³ Njoftim për shtyp SPAK <https://spak.al/2023/01/20/njoftim-per-shtyp-14/>

Ky raport është pjesë e projektit “FOL PËR DREJTËSINË”, që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Qendrës “FOL” dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

5. PUNA E QENDRËS FOL NË PËRDITËSIMIN E RASTEVE TË DROGËS, KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Ekspertët e Qendrës “FOL” nga muaji Gusht 2022 kanë monitoruar proaktivisht procesin e procedimeve penale të regjistruara pranë SPAK dhe regjistrimin në shkallët e gjykit. Ekspertët, në vijimësi të projektit të parë të përmbyllur suksesshëm “Fol për Drejtësinë 2020-2021”, kanë monitoruar gjendjen e gjykit të personave nën hetim në kategoritë e drogës, korrupsionit dhe krimit të organizuar të trajtuara në projektin e parë, me qëllim vlerësimin e punës së prokurorisë dhe gjykatës. Në këtë periudhë raportimi ekspertët e Qendrës “Fol” kanë populluar databazën “Fol” me **79 raste të reja** që i përkojnë periudhës gusht 2022 – janar 2023 dhe kanë përditësuar të dhënat për **197 raste** që i përkojnë periudhës Korrik 2020 – Tetor 2021.



Grafiku 9 Rastet e përditësuara nga periudha 2020- 2021 sipas kategorive


Nga 197 rastet e përditësuara shumica janë në fushën e korrupsionit(73%). Kategoria e dytë është droga dhe më pas krimi i organizuar.

Droga – Ekspertët e Qendrës “FOL” kanë përditësuar të dhënat lidhur me statusin e gjykit për shtetasit të cilët janë hetuar për kryerjen e veprave penale në fushën e drogës për periudhën korrik 2020 – tetor 2021. Nga 197 rastet e përditësuara nga projekti 2020 - 2021 janë **48 raste në fushën e drogës**.


Në 43 raste Prokuroria ka paraqitur kërkesën për gjykim, në 1 rast është vendosur për mosfillim dhe 4 raste është vendosur për pushimin e çështjes. Prokuroria argumentoi në kërkesën për pushimin e hetimeve se faktet e grumbulluara gjatë

hetimeve paraprake treguan se, pavarësisht dyshimeve të ngritura për personat nën hetim, dyshime të cilat nuk mbështeteshin me prova dhe nuk e kapërcenin dot këtë kufi, nuk provojnë se personat nën hetim të kenë kryer veprën penale.


Kohëzgjatja e çështjeve penale të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë përfshin datën e regjistrimit të çështjes në Gjykatë dhe datën e shpalljes së vendimit. Në 40 raste ekspertët kanë llogaritur kohëzgjatjen në ditë të gjykimit të çështjeve në fushën e drogës në Gjykatën e Shkallës së Parë.




Grafiku 10 Kohëzgjatja e çështjeve penale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për rastet e drogës të projektit Nëntor 2020 – tetor 2021



Grafiku 11 Pezullimi i dënimeve me burg për rastet e përditësuarra Nëntor 2020 – Tetor 2021



Grafiku 8 Shpërndarja e rasteve të përditësuarra Nëntor 2020- Tetor 2021 sipas neneve në fushën e drogës



Grafiku 13 Vendimet e Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë për rastet e përditësuarra në fushën e drogës Nëntor 2020 – Tetor 2021

Janë **43 shtetasit** e shpallur fajtor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kryerjen e veprave penale në fushën e drogës si “prodhim dhe shitje narkotikësh”, “prodhim dhe shitje narkotikësh në formën e tyre origjinale”, “trafikim narkotikësh” dhe “kultivim i bimëve narkotike” të sanksionuara në nenet 283, 283/1, 283/a dhe 284 të K. Penal. Më së shumti, në rreth 42% të rasteve shtetasit janë akuzuar për kryerjen e

veprës penale “Kultivim i bimëve narkotike”, në 39% të rasteve për veprën penale “Prodhim dhe shitje narkotikësh”. **Dënimi maksimal i dhënë për këto akuza është 10 vjet**(1 çështje ku i



pandehuri është akuzuar për veprën penale “*trafikim narkotikësh*”) dhe **minimali 1 vit e 9 muaj**(1 çështje ku i pandehuri është akuzuar “*Moskallëzim të krimit*” dhe “*mbajtje e armëve pa leje*”). Të 43 shtetasit e dënuar kanë paraqitur kërkesën për gjykimin e shkurtuar. Me ndryshimet ligjore nr. 41/2021, datë 23.03.2021 në Kodin e Procedurës Penale ⁴ është gjyqtari i seancës paraprake që verifikon aspektet formale dhe procedurale të kërkesës dhe shprehet lidhur me pranimin ose jo të saj. Gjyqtari i seancës paraprake ka pranuar kërkesën për gjykim të shkurtuar të të pandehurve. Për shkak të gjykimit të shkurtuar dënimi është ulur me 1/3. Dënimi më i shpeshtë ka qenë 5 vjet, që pas gjykimit të shkurtuar është zbritur në 3 vjet e 4 muaj. Ky dënim haset në **28 raste**. Nga këto **28 raste**, në **17** të tilla gjykata vendosi pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me vënien në provë për 3 vjet. Janë **11 shtetas** të dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për vepra në fushën e drogës, për të cilët nuk është pezulluar dënimi me burg por që vazhdojnë të shlyejnë dënimin në qeli. Janë **2 raste** kur shtetasit u shpallën të pafajshëm nga Gjykata pasi provat e grumbulluara nuk e vërtetonin akuzën.

Për periudhën e raportimit gusht 2022- janar 2023 në fushën e drogës, ekspertët e Qendrës “FOL” kanë monitoruar një çështje në të cilën, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në bashkëpunim me autoritetet italiane ka nisur hetimin për disa shtetas për konsumimin e veprave penale që lidhen me shpërndarjen e lëndëve narkotike, si pjese e një grupi kriminal që operon në disa zona në Itali. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me kërkesë të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka caktuar masën e sigurimit “arrest me burg” **për 20 shtetas** dhe masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi” për një shtetas tjetër, të akuzuar për përfshirje në

⁴ Ligj Nr.41/2021 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Ky raport është pjesë e projektit “FOL PËR DREJTËSINË”, që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Qendrës “FOL” dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.



grup të strukturuar kriminal, kryerjes së veprave nga grup i strukturuar kriminal dhe për prodhimin dhe shitjen e lëndëve narkotike.⁵

Korrupsioni – Ekspertët e Qendrës “FOL” kanë përditësuar databazën “Fol” me të dhëna të reja për rastet e korrupsionit të monitoruara gjatë periudhës Korrik 2020 – Tetor 2021. Janë 144 raste për të cilat ekspertët kanë përditësuar të dhënat lidhur me gjykimin. Nga këto 144 raste në 43 prej tyre Prokuroria ka paraqitur kërkesën për gjykim. Në 35 raste Prokuroria e Posaçme ka paraqitur kërkesën për gjykim ndaj të pandehurve. Në 31 raste Gjykata e Posaçme i ka shpallur të pandehurit fajtor. Në 18 raste kur është ankimuar vendimi në Gjykatën e Posaçme të Apelit ka rezultuar se në 17 raste Gjykata ka miratuar vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së parë, kurse në 1 rast ka ndryshuar vendimin.

KORRUPSIONI NË MINISTRI LINJE

Të pandehurit - ish-zëvendësministria e Brendshme dhe 2 shtetase të tjera

Vepra penale - “*Ushtrim i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike*” Neni 245/1 i K. Penal.

Masat e Sigurimit - Zv.ministër i Brendshëm në masë sigurimi personal “arrest në burg”, 2 shtetase në masë sigurimi “arrest në shtëpi”

Dënimi në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar - 1 vit e tre muaj burg, por për shkak të gjyimit të shkurtuar dënimi u ul me një të tretën.

Përfaqësuesit ligjorë të ish-zëvendësministres dhe 2 shtetasve kërkuar në Gjykatën e Posaçme të Apelit ndryshimin e masës së sigurimit.

Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më 11 janar 2023 miratoi lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë për shpalljen fajtores të ish-zëvendësministres së Brendshme dhe dy shtetase që bashkë me të u akuzuan për “ushtrim të ndikimit të paligjshëm”.

Komunikim për median i datës 11 janar 2023

<https://www.gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/njoftime-p%C3%ABr-median/>

⁵ <https://spak.al/2023/01/26/njoftim-per-shtyp-16/>

Ky raport është pjesë e projektit “FOL PËR DREJTËSINË”, që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Qendrës “FOL” dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

SHKELJA E BARAZISË NË TENDERA

Procedimi penal nr.82/2020

Numri i të pandehurve - 3

Vepra penale - "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", dhe "Shpërdorimi i detyrës" parashikuar nga neni 258 dhe neni 248 i Kodit Penal.

Masat e Sigurimit - "arrest në burg"

Vendimi GJKKO – fajtor dhe të dënuar përkatësisht me :

Një shtetas u dënua me 2 vite burg nën akuzën e shpërdorimit të detyrës ku si pasojë e aplikimit të gjykimit të shkurtuar, dënimi është reduktuar në 1 vit dhe 4 muaj heqje lirie; Dy shtetas, pas gjykimit të shkurtuar, janë dënuar me nga 1 vit burg secili. Për të tre shtetasit Gjykata ka vendosur për heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike për një afat kohor 5 (pesë) vjeçar.

Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar duke i lënë në burg për të vuajtur dënimin.

Komunikim për median i datës 7 dhjetor 2022

<https://www.gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/njoftime-p%C3%ABr-median/>

SHKELJA E BARAZISË NË TENDERA

Procedimi penal nr.82/2020

Numri i të pandehurve - 3

Vepra penale - "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike" dhe "Shpërdorimi i detyrës"

Ky raport është pjesë e projektit "FOL PËR DREJTËSINË", që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Qendrës "FOL" dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

PROKURIMET NË BASHKINË DURRËS

Procedimi penal - nr. 25 të vitit 2021

Të pandehur - 7 shtetas

Vepra penale - "Falsifikimi i dokumentave", "Shpërdorimi i detyrës", "Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike", , parashikuar nga nenet 186, 248, 258,25 të K. Penal
Masa e sigurisë - "arrest në burg"

Vendimi GJKKO - pas gjykimit me procedurë të shkurtuar, me vendim nr. 34, datë 26.05.2022, i dënoi përkatësisht me : 3 shtetas me 10 muaj e 20 ditë burgim dhe heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike ne 5 vitet e ardhshme; 4 shtetas me 11 muaj e 10 ditë burgim dhe heqjen e të drejtës për të ushtruar funksione publike ne 5 vitet e ardhshme. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar datë 04.01.2023, përfundoi shqyrtimin e çështjes së regjistruar me nr. 69 akti, datë 07.10.2022 ka lënë në fuqi vendimin e GJKKO-së

Komunikim për median i datës 4 janar 2023

<https://www.gjykata.gov.al/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/gjykata-e-posacme-e-apelit-per-korrupsionin-dhe-krimin-e-organizuar/njoftime-p%C3%ABr-median/>

5.1 Shpallja e moskompetencës

Ekspertët e Qendrës “FOL” kanë monitoruar rastet kur Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka shpallur moskompetencën lëndore, duke referuar çështjet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për periudhën gusht 2022 – janar 2023 është evidentuar vetëm **1 rast** kur Prokuroria e Posaçme, pas vlerësimit të materialit kallëzues e dërgoi për kompetencë në Prokurorinë e Tiranës. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi për mosfillim të procedimit penal.⁶

Rastet e tjera të monitoruara në drejtim të shpalljes së moskompetencës gjatë hetimeve paraprake nga SPAK janë ato për të cilat ekspertët kanë bërë përditësimin e të dhënave nga projekti 2020 – 2021. Nga **197 rastet** e përditësuara të periudhës nëntor 2020 – tetor 2021 në **29 raste** SPAK ka shpallur moskompetencën, duke referuar aktet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në 17 nga 29 rastet e moskompetencës vepra penale në shqyrtim ka qënë “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni **248 i K. Penal**.

Në vazhden e monitorimit të rasteve të moskompetencës, ekspertët e Qendrës kanë analizuar **9 procedime penale** ku shtetasit kanë konsumuar veprën penale “*Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike*” parashikuar nga **neni 244 i K. Penal**. Të gjithë shtetasit janë arrestuar në kushtet e flagrancës teksa kanë tentuar të korruptojnë punonjësit e policisë. Ndryshimet ligjore të vitit 2021, përkatësisht Ligji nr. 43/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”⁷ së bashku me ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale lidhur me kompetencën lëndore të Gjykatave të Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka prodhuar në këtë rast shpalljen e moskompetencës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të

⁶https://www.pp.gov.al/Tirane/Media/Prokuroria_Tirane_vendos_mosfillimin_e_procedimit_penal_ndaj_Autoritetit_te_Dosjeve.html

⁷ Ligj nr. 41/2021 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar <https://qbz.gov.al/eli/fz/2021/71>

Ky raport është pjesë e projektit “FOL PËR DREJTËSINË”, që mbështetet financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla i Komisionit për Demokraci i Ambasadës së SH.B.A.-së, në Tiranë. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Qendrës “FOL” dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

organizuar për këto çështje. Sipas këtij ligji, neni 244 i Kodit ka pësuar ndryshim duke përcaktuar në paragrafin e parë se premtimi, propozimi ose dhënia, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çfarëdo përfitimi të parregullt, **deri në vlerën 500,000 Lek ose ekuivalencën në monedhë të huaj**, personit që ushtron funksionin publik, për vete ose për persona të tjerë për të kryer ose mos kryer një veprim, që lidhet me detyrën ose funksionin e tij, dënohen me burgim nga **gjashtë muaj deri në 1 vit**.


Nga ana tjetër, në paragrafin e dytë është parashikuar se **kur përfitimi i parregullt i personit që ushtron funksionin publik**, për vete ose për persona të tjerë, **është mbi vlerën 50.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj**, vepra penale do të jetë e dënueshme me burgim nga **1 deri në 3 vjet**. Në të 8 rastet propozimi i të ndaluarve për përfitim të parregullt është nën 500,000 lekë. **Me amendimet që janë kryer në dispozitat e mësipërme janë miratuar ndryshimet përkatëse edhe në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, duke parashikuar kompetencën lëndore të gjykatave të posaçme vetëm për gjykimin e veprave penale në nenet 244 paragrafi 2, 245/1 paragrafët 2 dhe 4, 258 paragrafi 2 dhe 259 paragrafi 2 të Kodit Penal.**

Praktikisht Prokuroria e Posaçme ka dërguar për kompetencë çështjet në Prokurorinë e Tiranës. Prokuroria e Tiranës ka paraqitur kërkesën për gjykim për të pandehurit, të hetuar të gjithë në gjendje të lirë, për të cilët Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka shpallur fajtorë, i ka dënuar me burg, me gjykim të shkurtuar, dënimi fillimisht është ulur me një të tretat e më pas është pezulluar duke u konvertuar në shërbim prove në **6 raste** dhe në orë pune në interes publik në **3 raste të tjera**.

5.2

5.2 Kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve penale

Kohëzgjatja e çështjeve penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar përfshin datën e regjistrimit të çështjes në Gjykatë dhe datën e shpalljes së vendimit. **Janë 26 raste** për të cilët ekspertët kanë mundur të marrin informacion nga koha e regjistrimit në Gjykatën e Posaçme deri në datën e shpalljes së vendimit. Sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale në gjykimin penal në shkallë të parë, afati i gjykimit të krimeve duhet të jetë maksimumi 2 vjet dhe i kundërvajtjeve 1 vit, në gjykimin në apel përfundimi i gjykimit për krimet të jetë realizuar në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj dhe në Gjykatën e Lartë, përfundimi i gjykimit për krimet në një afat kohor prej 1 viti dhe për kundërvajtjet 6 muaj. Nga një vlerësim i realizuar për disa nga rastet për të cilat shqyrtuara nga ekspertët e Qendrës “Fol” në gjurmim të rasteve të korrupsionit për periudhën shkurt 2021- tetor 2021:



Grafiku 14 Kohëzgjatja e çështjeve penale në fushën e korrupsionit të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar llogaritur për rastet e përditësuara nga projekti Nëntor 2020 – Janar 2021

Për të llogaritur kohëzgjatjen e çështjeve penale të regjistruara në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është përfshirë intervali kohor nga data e regjistrimit të



çështjes në Gjykatë e deri në datën e shpalljes së vendimit. Në rast se do të realizohej një ndarje sipas periudhave (më pak se 1 muaj, 1 deri në 6 muaj, 7 deri në 12 muaj, 1 deri në 2 vjet, më shumë se 2 vjet) rezulton se **7 raste kanë një kohëzgjatje nga 1 në 6 muaj kurse 19 raste janë 7 deri në 12 muaj.**



DISA PROBLEMATIKA LIDHUR ME MONITORIMIN E ÇËSHTJEVE DHE AKSESIN NË INFORMACION

Gjatë fazës së monitorimit për hartimin e këtij raporti vlerësimi 6 mujor grupi i punës ka hasur në disa kufizime lidhur me informacionin e plotë dhe të publikuar online nga SPAK, Gjykata e Posaçme e Shkallës së parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Adresimi i këtyre problematikave do të kontribuonte në rritjen e transparencës së institucioneve respektive, por edhe në kryerjen e një analize sa më të plotë dhe të saktë në drejtim të shqyrtimit gjyqësor të çështjeve për korrupsionin dhe krimin e organizuar. Në faqen web të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar/Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në hapësirën e njoftimeve pasqyrohen përmbledhjet e seancave gjyqësore që nga dhjetori 2022 dhe mungon i përmbledhur për seancat që janë zhvilluar përpara kësaj periudhe. Gjatë hulumtimit ekspertët e Qendrës “FOL” kanë konstatuar se në faqen web të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar/Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar mungon publikimi i vendimeve të plota. Mendojmë që do të përbënte një zhvillim pozitiv në rast se:

- a) Do të publikoheshin vendimet e plota për çështjet penale për të cilat ka përfunduar gjykimi në Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- b) Do të realizohej publikimi i të dhënave për çështjet e viteve të kaluar;
- c) Do të realizohej përditësimi sistematik i statusit të çështjeve të regjistruara në Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.